

Bundle Interactive Shpk

NIPT: L82118020P

Durres

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 25/10/2021, ne Seline e shoqërisë Bundle Interactive Shpk, u perpilua dhe u nenshkrua kontrata e shitjes e kuotave nga personat e mëposhtëm:

1. **Z. Edvin Puriqi**, shtetas shqiptar, i datelindjes 26.03.1980, lindur ne Rubik dhe banues ne Tirane, me numer personal ID I00326134W, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;
2. **Z. Eduart Loci**, shtetas shqiptar, i datelindjes 14.04.1989, lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, me numer personal ID I90414085L, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar;

Të sipërpërmendurit, bazuar në nenin 73/1/b të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” dhe statutin e shoqërisë Bundle Interactive Shpk, hartuan me vullnetin e tyre te lire kete “Kontrate për shitje kuotash” si më poshtë vijon:

### Neni 1


#### Palët kontraktuese

1. Z. Edvin Puriqi, shtetas shqiptar, i datelindjes 26.03.1980, lindur ne Rubik dhe banues ne Tirane, me numer personal ID I00326134W, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, ortak i vetem i 100% të kuotave të shoqërisë “Bundle Interactive” Shpk, me NIPT: L82118020P dhe seli ne : Lagjja nr.2, rruga Aleksander Goga, pallat me nr.1355, kati i trete, Durrës, *këtu e më poshtë referuar si “SHITËSI”*, dhe
2. Z. Eduart Loci, shtetas shqiptar, i datelindjes 14.04.1989, lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, me numer personal ID I90414085L, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, *këtu e më poshtë referuar si “BLERËSI”*.

### Neni 2

#### Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga Shitësi kundrejt Blerësit të 100 % (njqind për qind) të pjesëve/kuotave ose 1 (nje) kuote/pjese të kapitalit, me një vlerë nominale prej 100.000 Leke (njqind mije lekë), që Shitësi zotëron në shoqërinë “Bundle Interactive” Shpk, dhe transferimi i tyre, nepermjet veprimit juridik te Shit-Blerjes, te Bleresi Z. Eduart Loci me 100.000 Leke (njqind mije lekë)ose 1 kuote/pjese te kapitalit.



### Neni 3

#### Çmimi i shitjes.

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësit është 100.000 (njëqind mije) lekë. Palët deklarojnë që çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate është likuiduar nga blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.

### Neni 4

#### Detyrimet e shitësit

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së 100 % të kuotave, që ai kishte në shoqërinë "Bundle Interactive" SHPK, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë me vullnetin e tij të lirë e të plote nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën objekt të kësaj kontrate.

Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tij në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

### Neni 5

#### Detyrimet e Blerësit

Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate.

Blerësi bie dakord dhe merr përsipër që menjëherë pas kalimit të pronësive të ndryshohe seline e shoqërisë.

### Neni 6

#### Gjuha e Kontratës

Kjo kontratë përgatitet në 2 ekzemplarë në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

### Neni 7

#### Te fundit

Pas përpilimit të kësaj kontrate, Shitësi dhe Blerësi, pranuan përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë e nënshkruan atë.

PALET

SHITËSI

Z. Edvin Puriqi

*Edvin Puriqi*

BLERËSI

Z. Eduart Loci

*Eduart Loci*

